REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 13/17
Datë/Datum. 02.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 13/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Goran Milenković - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues "Telekomi i Kosovës Sh.a" - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, me titull: "Shërbime të telefonisë mobile për Komunën e Gjakovës", me nr prok: "632/16/072/221", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Komuna e Gjakovës/, më datën 28.02.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet,** si e pa bazuar ankesa e OE "Telekomi i Kosovës" Sh.a - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime të telefonisë mobile për Komunën e Gjakovës",me nr prok: "632/16/072/221", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Komuna e Gjakovës/.

II. **Vërtetohet,** vendimi për dhënie të kontratës i AK-së /Komuna e Gjakovës/, me titull: "Shërbime të telefonisë mobile për Komunën e Gjakovës", me nr prok: "632/16/072/221".

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Operatorit ekonomik ankues "Telekomi i Kosovës" Sh.a - Prishtinë, i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që pretendimet ankimore janë të pa qëndrueshme.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:11.11.2016.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 05.12.2016, ku kanë marr pjesë dy (2) operatorë ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me dt: 29.12.2016, e ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "IPKO Telecommunications LLC" - Prishtinë.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, operatori ekonomik "Telekomi i Kosovës" Sh.a - Prishtinë, me dt: 04.01.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt:05.01.2016, autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Telekomi i Kosovës" Sh.a - Prishtinë.

Operatori ekonomik "Telekomi i Kosovës" Sh.a - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 16 janar 2017 me nr.13/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës me titull: "Shërbime të telefonisë mobile për Komunën e Gjakovës", me nr prok: "632/16/072/221", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 7 i LPP-së – Barazia në trajtim/jo diskriminim
- Neni 9.4 i LPP-së- Përcaktimi i nevojave që duhet të përmbushën
- Neni 38.7 i LPP-së- Kontratë Kornizë
- Neni 27 i LPP-së- Dosja e tenderit.
- Neni 28 i LPP-së- Specifikat teknike

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 30 janar 2017, i ka rekomanduar panelit shqyrtues që të Aprovoj si të Bazuar ankesën e OE "Telekomi i Kosovës" Sh.a – Prishtinë, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të Anuloj vendimin "Njoftimi për dhënie të kontratës i

datës 29.12.2016 "Shërbime të telefonisë mobile për Komunën e Gjakovës" me nr prok: "632/16/072/221" të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues "Komuna e Gjakovës" dhe lënda të kthehet në Ritenderim, nëse edhe më tutje ka interes Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit.

Operatori ekonomik ankues "Telekomi i Kosovës" Sh.a - Prishtinë, me datë: 01 shkurt 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues me datë: 03 shkurt 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 28.02.2017, ku kanë qenë prezent palët e përfshira në procedurë, kryetari i panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues dhe vëhzguesit nga OJQ "DPlus", ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Telekomi i Kosovë Sh.a" ka deklaruar: "Siç kemi deklaruar në ankesë përpos neni 9.4, ka pas shkelje edhe të nenit 38 dosja tenderit nuk ka qenë e hartuar mirë për shkak disa kërkesave si janë ajo për subvencionim sipas ligjit është e pakuptim. Këtë e kemi pas edhe pyetje sqaruese pranë AK-së mirëpo nuk kemi marr përgjigje. Edhe specifikat teknike tek telefonat ka qenë specifikimi i përgjithësuar, psh është thënë telefona të teknologjisë së fundit, që mund të jenë prej vlerës 80 euro deri 1000€. Mirëpo me që periudha para hapjes për ankesë në AK nuk e kemi ushtruar sipas ekspertit nuk është marr me çështjen andaj mbesim vetëm tek nenin 9.4".

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së "Komuna e Gjakovës" ka deklaruar: "AK ka kërkuar shërbim me cilën specifikat i ka bërë që të mos ketë diskriminim dhe sa më të kuptuara për OE-të. Kjo vërtetohet me dosje ku janë vendos minimumi dhe maksimumi për secilin shërbim me qëllim ti ofrohet secilit OE drejta e ofertimit. Përveç kësaj pretendimet e OE , nëse shihet dosja nga ana e AK apo nga OSHP, ne nuk kemi përmend subvencionim në mobile me vlere 1000€ siç pretendon OE ankues, por kemi kërkuar që të kemi pajisjet e nevojshme për shërbimin që do ofrohet e cila do regjistrohet si shërbim nga OE për AK-në, me qenë se gjithë zyrtarëve komunal duhet të ju sigurohet numër kontakti nga OE që do fitoj, dhe si rezultat i kësaj ne nuk kemi mundësi të ju blejmë pajisje që ofrojnë një shërbim të tillë. Dhe këto regjistrohet normalisht pasuri e komunës. Ne kemi paraparë 45.000 € komplet buxhetin për dy vite, bazuar në shpenzimet e viteve 2013-2014-2015. Por normalisht është e mirëseardhjes për KK Gjakovë që OE ekonomikisht më i favorshëm të ndihmoj në kursimin e buxhetit të komunës. Sa përket pretendimi të OE që është shkel neni 28.2, 7, 6, AK pas shqyrtimit të detal të pretendimeve me datë 05.12.2016 i ka kthyer OE përgjigje duke specifikuar saktë qasjen e AK pa dashtë të bëjë cenim të drejtës konkurruese në tregun e Kosovës. Neve në përgjigjen dërguar me 03.02.2017 ku nuk jemi pajtuar me përgjigjen e

ekspertit , eksperti ka qartësuar vetëm pikën 9.4 dhe jo nenet tjera, por që te pika 9 ne kemi kthyer përgjigje dhe të njëjtën ia kemi dërguar për sqarim Autoritetit të konkurrencës së Kosovës në kuadër të Kuvendit të Kosovës pasi që pretendimet e këtij neni diskriminojnë OE tjerë që ofrojnë shërbime në Kosovë dehe dalin jashtë konkurrencës, mirëpo ne kemi pranuar përgjigje nga KRPP që pavarësisht përgjigjes ka lejuar AK-në të nisë procedurat e prokurimit, njoftimin për kontratë, dhe ne nuk kemi pranuar nga MAP një marrëveshje të nënshkruar mes MTI për shërbimin e ofruar, por vlen të theksohet se në 2014 KK Gjakovë ka nënshkruar kontratë me Telekomin deri me 2016 vetëm për faktin se kemi pas marrëveshje me ministrinë që nuk ka vazhduar më tutje. Pasi nuk kemi pas marrëveshjet të tillë kemi dashtë të respektojmë LPP për mos diskriminim të konkurrencës që janë edhe pjesë e kushtetutës ë Kosovës , që janë cekur me datë 03.02.2017 si përgjigje OSHP. Kërkojmë nga OSHP të analizoj edhe njëherë gjithë dosjen dhe të shikoj ligjet tjera ndërlidhëse nëse pretendimet e OE qëndrojnë të drejta, sepse sipas AK-së kemi zbatuar ligjin në tërësi.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues i OSHP-së ka deklaruar: "Sqaroj se kemi të bëjmë me procedurë për shërbime telefonike, e ika ka sjell një paqartësi qe një kohë të gjatë mes Telekomit dhe AK-ve në Kosovë për këtë shërbim. Pasi siç pretendon Telekomi sipas nenit 9.4 të LPP-së, kjo procedurë nuk ka nevojë të publikohet si procedurë e hapur por të vazhdohet me lidhje të kontratës direkt me PTK Telekomi i Kosovës. Po ashtu në këtë aktivitet të prokurimit OE ankues ka parashtruar në ankesë pretendime se neni 9.4 dhe neni 7 dhe 28 lidhur me specifikat teknike apo dosjen e tenderit. Un kam shqyrtuar vetëm nenin 9.4 si pretendim kryesor, ndërsa nenet 7 dhe 28 për kriteret e dosjes , në fazën e tenderimit është dashtë të parashtroj ankesë, dhe në këtë fazë ky pretendim nuk mund të shqyrtohet. Sa i përket neni 9.4 , bazuar në interpretimin e KRPP , kryetari i KRPP dhe bordi lidhur me këtë çështje, Telekomi i Kosovës është autoritet publik, në bazë të interpretimit AK duhet vepruar në harmoni me nenin 9.4 siç është rasti me këtë aktivitet dhe i mundësohet të përjashtohet nga procedura edhe të vazhdohet me Telekomin e Kosovës siç janë duke e shfrytëzuar shumë AK në Kosovë. Un nuk kam mund të gjejë ndonjë legjislacion ndryshim lidhur me këtë interpretim. Derisa nuk ka dispozitë tjetër duhet të respektojmë këtë të KRPP.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: "Bazuar në atë se ka mbet vetëm neni 9.4, çdo AK është i thirrur që çdo procedurë të prokurimit dhe shfrytëzim të parasë publike ta zhvilloj sipas LPP dhe vetëm sipas LPP. Gjatë hartimit të deklaratës së nevojave neni 2 par.2 thotë "Çdo AK publik para se të filloj me procedurë të prokurimit duhet sigurohet që prokurimet e tilla nuk janë në shërbim nga ndonjë AK tjetër publik", kjo është shkelja parë e AK-së , pasi neni 9.4 kërkon këtë çështje. Interpretimin e tillë e ka bërë KLRPP para dy viteve ku këtë çështje e ka quajtur blerje në shtëpi, dhe sqaron që për prokurime tilla nuk ka nevojë të përdoret LPP mirëpo ët të shkohet në marrëveshje korporatave sepse si Telekomi ashtu edh tjera llogaritet janë AK të shtetit dhe shfrytëzojnë paranë e përbashkët ku dividenta e PRK shkon edhe për komuna, dhe s'ka kuptim të blihet prokurime jashtë institucionit. Këtu çmimet janë konkurrente dhe është e paarsyeshme të kalohet në këtë pikë. Për këtë kemi kërkuar nga KRPP përgjigje ku me 03.11.2016 na janë përgjigjur me interpretim e cila është autoriteti i vetëm për interpretim të LPP-së, në cilin thuhet që për prokurime të tilla çdo AK publik duhet përjashtuar LPP dhe direkt të bëjë marrëveshje korporatave, duke u bazuar në çmimet e tregut. I propozojmë panelit shqyrtues që të

anulohet kjo procedurë e prokurimit dhe AK të vazhdoj me marrjen e shërbimeve sipas 9.4 dhe të kaloj marrëveshje me Telekomin si ofrues i shërbimeve ku aksionar i vet i Telekomit është Qeveria Kosovës. Dhe me këtë bie në vend thënia blerje në shtëpi.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK ka deklaruar: "Kemi cek vetëm pikat që mendojmë dhe jeni të sigurt se AK e ka plotësuar plotësisht legjislacionin në fuqi filluar nga KRPP. Fillimisht Telekomi funksionon sipas ligjit për ndërmarrje publike, që automatikisht edhe ndërmarrjet komunale siç është Qabrati funksionojnë sipas ligjit për ndërmarrje publike, mirëpo që në këtë rast KERPP flet e ka obliguar KK Gjakovë të bëjë procedurë të hapur dhe të mos i jep direkt Qabratit mirëmbajtjen e gjelbërimit në Komunë. E dyta neni 7 barazia në trajtim dhe neni 6 , me këtë rast AK është bazuar që të mos ketë diskriminim dhe njëkohësisht OE IPKO ka qenë ekonomikisht më i favorshëm dhe automatikisht tregon kursim të buxhetit prej 976.56€ më pak se Telekomi i Kosovës. Sa i përket nenit 9.4 ku thuhet se AK i tillë duhet të merr masa të arsyeshme se lëndët që përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë Autoritet tjetër publik, në rastin konkret mendojmë që edhe KRPP përgjigja tyre decidivisht nuk specifikon se me këtë nen duhet shkuar me kontratë një burimore. Në këtë rast në momentin kur AK i dorëzon në KRPP njoftimin për kontratë , KRPP ka bërë publikimin e saj ku rastet tjera ndodh që edhe nuk e pranon publikimin, kurse Telekomi pavarësisht faktit ka ofertuar, ka pranuar të bëhet pjesë e prokurimit, dhe deri në momentin kur është bërë dhe ka kuptuar se nuk është përzgjedh Telekomi atëherë ka bërë ankesë. I propozojmë panelit shqyrtues që të shikoj në detaje dosjen e tenderit, përgjigjen e ofruar për OSHP-në nga KK Gjakovë duke cek gjitha nenet përfshirë edhe Kushtetutën e Kosovës dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Paneli shqyrtues pas analizimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, ekspertizës së ekspertit shqyrtues, si dhe të gjitha argumenteve dhe fakteve relevante, sqaron autoriteti kontraktues ka zhvilluar procedurë të hapur, kontratë për shërbime me vlerë të mesme, e për të cilën procedurë është bërë njoftimi për kontratë dhe sipas dëshmive nuk ka pasur ndonjë vërejtje nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP), si institucion kompetent për të verifikuar njoftimet për publikim si dhe të gjitha kërkesat në lidhje me këto publikime.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha dëshmitë e prezantuara nga palët në procedurë, sqaron dhe konstaton se nuk ka pasur asnjë kërkesë për rishqyrtim dhe asnjë ankesë në lidhje me njoftimin për kontratë dhe me dokumentet e tenderit përkitazi me këtë procedurë të hapur të prokurimit ashtu siç parashihet me nenin 108/A paragrafi 3.1 i LPP-së. Ky fakt dëshmon se operatori ekonomik ankues "Telekomi i Kosovës Sh.a"- Prishtinë nuk ka pasur vërejtje lidhur me zhvillimin e kësaj procedurë të prokurimit dhe dëshmon se është pajtuar për të ofertuar në këtë mënyrë, siç është bërë shpallja dhe publikimi i njoftimit për kontratë. Prandaj duke pasur parasysh të gjitha këto fakte rezulton se operatori ekonomik ankues nuk i ka shfrytëzuar afatet ligjore për të apeluar dhe kundërshtuar njoftimin për kontratë dhe dokumentet e tenderit ashtu siç parashihet në dispozitat e lartpërmendura të LPP-së dhe siç parashihet edhe në nenin 4 paragrafi 1 pika a) te Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave.

Paneli shqyrtues konstaton pretendimet e OE ankues në lidhje me mos respektimin e nenit 7 përkitazi me nenet 9.4, 27, 28 të LPP-së janë të parashikuara dhe të lejuara të bëhen konform dipozitave të nenit 108/A të LPP-së, para ofertimit, e jo siç ka vepruar OE ankues pas rekomandimit për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran MILENKOVIČ

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Komuna e Gjakovës"

1x1 OE – "Telekomi i Kosovë Sh.a"

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.